



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.12/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Naim Mehulli**, në çështjen juridike të paditëses: nga kundër të paditurit: “ ” të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim, baza e kontestit: **Kompensim i pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar**, në seancën e datës: 17.07.2017, konform nenit 148 të LPK-së bijën këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

- 1. APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe
- 2. OBLIGOHET** i padituri në që në emër të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një për shpërblimi jubilar për katërdhjetë e pesë vjetorin e punës t'ia paguaj paditëses nga shumën prej 1226.94 euro-cent brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm,
- 3. Secila pale i barte shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësja nga me datë: 10.01.2017 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit “ ” ne për pagës te dy pagave për shpërblim jubilar dhe dy paga përcjellëse.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 17.07.2017 . Në këtë seancë pala paditëse deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiësë, deklaroi se ne muajin e trete te vitit 2016 kam pranuar një page nga punëdhënësi im me rastin e pensionimit, tani beje precizimin e kërkesëpadiësë ashtu qe meqenëse kam pranuar një page tani kërkoj vetëm tri paga dhe atë ne shume te tërësishme prej 1226.94 euro-cent, kështu qe me kompensohet ne emër te pagave përcjellëse dhe ne emër

Përfaqësuesi i të paditurit në seancë deklaroi se nuk e kontestojmë kërkesëpadinë e precizuar pas përmirësimit në këtë seancë për realizimi e të drejtës për kompensim të tri pagave nga 408.98 euro-cent që në total bëjnë 1226.94 euro-cent.

Meqenëse kërkesëpadia e paditëses nuk u kundërshtua në aspektin e bazës nga ana e përfaqësuesit të të paditurës, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm mori aktgjykim në bazë të pohimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejshëm në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,
C.nr. 12/2017 Me dt.17.07.2017.**

**GJYQTARI,
Naim Mehulli**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat 15 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.

SHKURTORI I GJYKATËS
TRASHKËRIM I GJYKATËS

Punëtor i Gjykatës
Or. Bećanović

